



Pranuar / Dorezuar Prilimjen/Prodato Received/Delivered	14.12.2021	viti god year	2021
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	6119/2021		116



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.896/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani –anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.896/2021 të datës 01.11.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë: Rruga "Bekim Berisha (Abeja) " Nr.146-Begaj, Vushtrri , kundër Vendimit KA.nr.49/2021 te datës 23.09.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** ankesa me numër A.nr. 896/2021 e datës 01.11.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. **MBETET në fuqi** Vendimi me numër KA.nr.49/2021 i datës 23.09.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 20.05.2021 ka shpallur konkursin me Nr: 03/2021 për pozitën "Zyrtar Ligjor 1 -në Gjykatën Themelore në Prishtinë-9 pozita" , Gjykata Themelore në Mitrovicë 5 pozita, Gjykata Themelore në Mitrovicë dega në Vushtrri 4 pozita, Gjykata Themelore në Mitrovicë –dega në Skenderaj 1 pozitë, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili është ftuar të marrë pjesë në testin me shkrim dhe intervistën me gojë mirëpo nuk është përzgjedhur si kandidatë i suksesshëm për asnjërën pozitë.

Më datën 20.08.2021 Sekretari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka publikuar njoftimet për kandidatët e suksesshëm me numër:03/1399, Nr.03/1405, nr.03/1406 dhe nr.1394 për pozitë Zyrtar Ligjor në Gjykatën Themelore në Prishtinë-9 pozita" , Gjykata Themelore në Mitrovicë 5 pozita, Gjykata Themelore në Mitrovicë dega në Vushtrri 4 pozita, Gjykata Themelore në Mitrovicë –dega në Skenderaj 1 pozitë,

I pakënaqur me njoftimet e datës 20.08.2021, ankuesi më datë 06.09.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 09-1444 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës më

datë 23.09.2021 nxjerr Vendimin me numër KA.nr.49/2021 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit me numër KA.nr.49/2021 të datës 23.09.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 29.10.2021 nëpërmjet postës ka parashtruar ankesë e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar me datë 01.12.2021 dhe numër protokollit 5216/2021 me pretendimet ankimore se procedura e rekrutimit lidhur me konkursin e lartë cekur është zhvilluar në kundërshtim me neni 37 dhe 38 Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil është zbatuar sipërfaqësisht.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.11.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Sekretari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 15.11.2021 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me shkresat e procedurës së zhvilluar me provat e bashkangjitura të lëndës dhe është protokolluar me numër:5439/2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjen në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 04.10.2021 me numër protokollit 4873/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 15.11.2021 me numër protokollit 5439/2021 bashkë me shkresat e lëndës. Vendimi KA.nr.49/2021 me nr.protokollit 1544 të datës 23.09.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ankesa e datës 06.09.2021 me numër protokollit 1444 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Kërkesa për punësim e datës 01.06.2021 për bashkë me dokumentacionin e kërkuar. Çertifikatë e datës 21.11.2019 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë për përfundimin e praktikës Gjyqësore prej datës 22.11.2018 deri më 21.11.2019, kopja e letërnjoftimit. Çertifikatë e datës 24.05.2021 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë. Vërtetim i datës 26.05.2021 për regjistrimin master në fakultetin Juridik . Rekomandim i datës 25.05.2021. Rekomandim i datës 27.05.2021. Kopja e testit me shkrim i datës 30.07.2021 për Agim Gashnjni. Udhëzues për testin me shkrim i datës 30.07.2021 me 64.5 pikë. Lista e aplikacioneve të pranuar për konkursin e shpallur për zyrtarë ligjor në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-dega Skenderaj. Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë për pozitën Zyrtar ligjor në Gjykatën Themelore dega në Vushtrri. Regjistri i aplikacioneve të pranueshme për pozitën Zyrtar ligjor në Gjykatën Themelore dega në Vushtrri. Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë për pozitën Zyrtar ligjor në Gjykatën Themelore dega në Prishtinë. Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë për pozitën Zyrtar ligjor në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega në Prishtinë. Lista e kandidatëve për testim me shkrim për pozitën Zyrtar ligjor. Vendim i datës 21.07.2021 me numër protokollit 1292 për emërimin e Komisionit Përzgjedhës për zgjedhjen e kandidatit për konkursin e shpallur për tre zyrtarë ligjor . Kopja e konkursit i datës 20.05.2021 për pozitën bashkëpunëtor profesional për 59 pozita dhe përshkrimi i detyrave të punës. E-mail zyrtar i datës 04.06.2021. Njoftimi i datës 20.08.2021 për përzgjedhjen e 5 pozitave Zyrtar ligjor në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Raporti final i rekomandimit nga Komisioni rekrutues. Renditja përfundimtare e kandidatëve. Përmbledhja e vlerësimeve individuale. Përcaktimi i kriterëve për testim me shkrim dhe me gojë. testi me gojë i datës 13, 14,15.dhe 16 gusht 2021. Regjistri i aplikacioneve të pranuar . Deklaratat e anëtarëve të Komisionit e datës 23.07.2021 për mosekzistimin e konfliktit të interesit. Kopja e testit me shkrim e datës 30.07.2021 për bashkë me dokumentacionin e kërkuar. Diploma e datës 19.09.2018 e lëshuar nga fakulteti juridik në Mitrovicë. Çertifikatë e datës 26.05.2021 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë. Çertifikatë e datës 12.03.2020 për përfundimin e praktikës gjyqësore prej dt.11.03.2019 deri me dt.11.03.2020 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Kopja e letërnjoftimit. Aneks marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 18.03.2021 në Panelin zgjedhor për ankesa dhe parashtrësa. marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 01.02.2021 në Panelin zgjedhor për ankesa dhe parashtrësa. Kopja e testit me shkrim për bashkë me dokumentacionin e kërkuar, kopja e letërnjoftimit, Aplikacioni për bashkë me dokumentacionin e kërkuar, kopja e letërnjoftimit,

Çertifikata e datës 24.05.2021 e lëshuar nga Gjykata Themelore Mitrovicë, Vërtetim i datës 26.09.2019, Vërtetim i datës 01.07.2020, Ës Vërtetim i datës 25.05.2021, Marrëveshje për kryerjen e praktikës e datës 01.10.2019, Marrëveshje për kryerjen e praktikës e datës 02.03.2020, Servis kontrat e datës 02.03.2020, Marrëveshje për kryerjen e praktikës e datës 04.05.2020, Marrëveshje për kryerjen e praktikës ëe datës 14.09.2020, Kontratë e shërbimeve, Kontratë e marrëdhënies së punës për kohë të caktuar për praktikant e datës 15.05.2018, Letër referencë e datës 21.05.2021, Letër referencë e datës 30.10.2018, Letër rekomandimi e datës 23.09.2019, Letër referencë e datës 24.05.2021, Aplikacioni për _____ e datës 02.06.2021, Kopja e letërnjoftimit, Diploma e datës 02.02.2017 me nr.4507 e lëshuar nga fakulteti juridik –Universiteti i Prishtinës-Hasan Prishtina, Çertifikata e notave e datës 15.01.2013, Çertifikatë e datës 24.02.2021, Çertifikatë e datës 01.02.2018, Vërtetim i datës 12.01.2018, Referencë e datës 27.09.2018, Letër rekomandimi e datës 31.05.2021, Çertifikatë e muajit janar 2021, Diplomë për kryerjen e kursit të kompjuterëve, Çertifikatë e datës 30.05.2013, Testi me shkrim për _____ i datës 30.07.2021, Udhëzues për testin me shkrim i datës 30.07.2021, Çertifikatë muajit gusht 2018, Çertifikatë e datës 25.06.2020, Çertifikatë e datës 04.06.2013, Testi me shkrim për _____ i datës 30.07.2021, Aplikacioni për _____ e datës 25.05.2021, Kopja e letërnjoftimit, Diploma e datës 17.10.2018 e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin Hasan Prishtina në Prishtinë, Çertifikata e notave e datës 03.02.2020, Marrëveshje për Shërbime të veçanta e datës 08.01.2021 Marrëveshje për Shërbime të veçanta e datës 28.08.2020 Çertifikatë e datës 12.03.2020, Vërtetim i datës 04.06.2020, Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë, Vërtetim i datës 08.03.2019, Vërtetim i datës 02.11.2017, Letër referencë e datës 17.08.2020, Letër rekomandimi i datës 11.02.2021, Rekomandim i datës 12.02.2021, Rekomandim i datës 02.11.2017, Çertifikatë e datës 26.11.2018, Çertifikatë e datës 03.04.2018, Çertifikatë e datës 05.03.202 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë-dega në Skenderaj, Rekomandim i datës 02.11.2017 për _____ praktikante në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-dega në Skenderaj praktikante studentore prej dt.01.06.2017 e gjer me dt.01.09.2017, Çertifikatë e datës 04.05.2018, Çertifikatë e datës 26.11.2018, Çertifikatë e datës 20.01.2017, Njoftimi i datës 20.08.2021 me nr.03/1406, Raporti final i rekomandimit nga Komisioni i rekrutues për pozitën zyrtar ligjor në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri; Propozim për emërimin e kandidatit të rekomanduar; Përcaktimi i kritereve për përfshirjen në listën e ngushtë e datës 23.07.2021; Përcaktimi i kritereve për testin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për datën 13, 14, 15 dhe 16.08.2021; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Renditja përfundimtare e kandidatëve ; Regjistri i aplikacioneve të pranuar për pozitën zyrtar ligjor në Gjykatën Themelore dega Vushtrri; Deklaratat e Komisionit Përzgjedhës për mosekzistimin e konfliktit të interesit të datës 23.07.2021; pikët e fituara në testin me shkrim dhe me gojë për _____ cila ika marrë 87.75 pikë; Udhëzues për testin me shkrim i datës 30.07.2021; Çertifikatë e datës 05.05.2018; Çertifikatë e datës 14.01.2019; Çertifikatë e datës 09.04.2015; Çertifikatë e datës 23.07.2018; Mirënjohje e vitit 2018; Çertifikatë e muajit dhjetor 2015; Çertifikatë e datës 05.12.2014; Çertifikatë e datës 16 dhe 17.05.2015; Çertifikatë e datës 17.12.2018; Diploma e datës 12.09.2021 me nr.6455 e lëshuar nga fakulteti Juridik në universitetin “Hasan Prishtina” në Universitetin e Prishtinës për _____ Vlerësimi i testit me shkrim dhe me gojë nga komisioni Përzgjedhës për _____ me 73.pikë; Udhëzues për testin me shkrim të datës 30.07.2021 për _____ Kërkesa për punësim e datës 24.05.2021 për _____ Kërkesa për punësim e datës 28.05.2021 për _____ Kopja e letërnjoftimit ; Pasqyra e llogarisë së Trustit për _____ Aneksi kontratë e datës 02.03.2020; Kontratë pune e datës 01.05.2015; Referencë e datës 25.01.2021; Referencë e datës 27.05.2021; Letër rekomandimi i datës 26.05.2021; Vërtetim i datës 13.04.2018; Çertifikatë e Universitetit Hasan Prishtina për vitin 2018/2019; Çertifikatë prej datës 11.10.2018 deri më 17.01.2019; Çertifikatë e muajit shtator-nëntor 2018; Vërtetim i datës 06.07.2021; Marrëveshje për angazhim në masën e akteve të tregut të punës i datës 02.06.2018; Marrëveshje për angazhim në masën e akteve të tregut të punës i datës 03.12.2018; Diplomë e shkollës së mesme: Diplomë e datës 20.09.2018 me nr.5709 për _____ e lëshuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës; Diploma master e datës 24.02.2021 me nr.2628 e lëshuar nga Fakulteti Juridik; Kopja e letërnjoftimit : Çertifikatë e datës 20.05.2021 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë-dega në Vushtrri; Vlerësimi i testit me shkrim dhe me gojë nga Komisioni vlerësues për _____ me 77 pikë; Udhëzues për testin me shkrim për _____ i datës 30.07.2021; Diploma e datës 19.09.2018 me nr.11 e lëshuar nga Fakulteti Juridik Universiteti “Hasan Prishtina” në Prishtinë për Kaltrina

Sfianja: Certifikatë e datës 16.03.2020 e lëshuar nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë; Certifikatë e datës 24.11.2020 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë-dega në Vushtri; kopja e letërnjoftimit: Letër komanduese nga gjyqtari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-dega në Vushtri; Referencë e datës 10.03.2020; Certifikatë e muajit janar 2018; Certifikatë e datës 04.05.2018; Vlerësimi i testit me shkrim dhe me gojë nga Komisioni vlerësues për me 71.5 pikë; testi me shkrim për Kërkesa për punësim e datës 25.05.2021 për Kontratë pune për kohë të pacaktuar e datës 08.11.2019; Vërtetim i datës 22.04.2020; Akt emërim i datës 10.06.2020; Vërtetim i datës 24.05.2021 i lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Certifikatë e datës 30.10.2016; Certifikatë e muajit dhjetor 2015; Certifikatë e 30.11.2018; Diploma e datës 10.09.2020 nr.700 e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina " për Njoffimi për përzgjedhjen përfundimtare zyrtar ligjor në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-dega Skenderaj dhe Përgjigje në Ankesë nga organi i punësimit i datës 15.11.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e **pubuzuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit dhe analizimit të provave të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datën 20.08.2021 ka publikuar njoftimet për kandidatët e suksesshëm me numër:03/1399, Nr.03/1405, nr.03/1406 dhe nr.1394 për pozitë Zyrtar Ligjor në *Gjykatën Themelore në Prishtinë-9 pozita* , Gjykata Themelore në Mitrovicë 5 pozita, Gjykata Themelore në Mitrovicë dega në Vushtri 4 pozita, Gjykata Themelore në Mitrovicë –dega në Skenderaj 1 pozitë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit se dyshon në numërimin e pikëve të testit me shkrim i mbajtur me datën 30.07.2021 nga Komisioni Përzgjedhës është i paqëndrueshëm sepse është konstatuar se ankuesi z kishte arritur 64.5 pikë, ndërsa në listën përfundimtare kishte arritur 350.25 pikë. Kriteret e konkursit për pozitën "Zyrtar Ligjor", kanë qenë:

"Diplome Universitare-Fakulteti Juridik dhe Një (1) vit përvojë pune profesionale".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë analizimit të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankuesi me datë 01.06.2021 ka aplikuar në konkursin e lartë cekur dhe po ashtu i njëjti sipas Diplomës me numër:5898 të datës 01.11.2015 dëshmohet se i ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik të "Universitetit të Prishtinës" . Praktikën Gjyqësore e përfundoi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në kohëzgjatje prej (një) viti nga data 22.11.2018 deri më datën 21.11.2019. Po ashtu, në bazë të shkresave të lëndës të administruara dhe të evidentuara në këtë vendim, të nëntë (9) kandidatët e përzgjedhur sipas njoftimit të datës 20.08.2021 për pozitën "Zyrtar Ligjor I në Gjykatën Themelore të Prishtinës" i kanë plotësuar kriteret e konkursit, kanë të mbaruar Fakultetin Juridik dhe kanë më shumë se një (1) vit përvojë pune pas diplomimit, andaj me rastin e përfshirjes në listën e shkurt sikurse të ankuesit ashtu edhe të nëntë (9) kandidatëve të përzgjedhur, Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 i cili ka përcaktuar se: *"1.Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë:1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional; si dhe 1.2. përvoja e punës"* pasi që ka vlerësuar drejtë përmbushjen e kriterëve të konkursit nga kandidatët e lartcekur.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi në testin me shkrim ka arritur (64.5) pikë, andaj me rastin e ftesës për intervistim me gojë Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 36 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *"Kandidatët të cilët e kalojnë me sukses testimin me shkrim dhe arrijnë të mbledhin së paku 50 % të maksimumit të pikëve të përcaktuara nga KPSHC pranohen të hyjnë të testit me gojë...."*. Po ashtu, Kolegji gjatë analizimit të formularëve të datës

30.07.2021 ne të cilët evidentohen pikët e testit me shkrim dhe vlerësimin të intervistës me gojë është konstatuar se ankuesi është vlerësuar nga të gjithë anëtarët edhe në fushën e kritereve të përzgjedhjes siç janë: *“Personaliteti dhe Planet Profesionale; Njohuritë e Përgjithshme Institucionale dhe Ekonomike; Njohuritë që Lidhen me vendin e Punës”* siç përcaktohet edhe me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 38 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 se: *“Kandidatët të cilët kalojnë me sukses testimin me shkrim i nënshtrohen testimit me gojë, e cila përbehet prej këtyre pjesëve: 1.1 Personaliteti dhe Planet Profesionale; 1.2 Njohuritë e Përgjithshme Institucionale dhe Ekonomike dhe 1.3 Njohuritë që Lidhen me vendin e Punës”*, andaj mbi bazën e këtyre fakteve Komisioni Përzgjedhës ka kryer detyrat e përcaktuara në nenin 7 paragrafin 7 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të Raportit të datës 19.08.2021 për renditjen përfundimtare të kandidatëve, ka konstatuar se kandidatja e përzgjedhur si më e vlerësuar është vlerësuar me 451.5 pikë, ndërsa kandidati i nëntë apo e fundit në listën e të përzgjedhurve është vlerësuar me gjithsejtë 385.75 pikë, ndërsa ankuesi si pikë të përgjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë në bazë të Formularit Form MAP-SHCK-08a ka arritur të grumbullojë gjithsejtë (350.25) pikë, me çka konstatohet se ankuesi nuk ka arritur pikë të mjaftueshme që të jetë në mesin e kandidatëve të përzgjedhur siç përcaktohet me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 të Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 40 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *“Në shërbimin civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”*.

Andaj mbi bazën e të gjeturave si më lart, Kolegji ka konstatuar se procedura e rekrutimit për pozitën *“Zyrtar Ligjor 1 -në Gjykatën Themelore në Prishtinë-nëntë pozita”* e shpallur me konkursin Nr: 03/2021 të datës 20.05.2021 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është zhvilluar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.03-L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 11 paragrafi 1 i cili përcakton se: *“Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve”* si dhe nenin 18 paragrafi 1 i të njëjtit ligji i cili përcakton se: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës”*, ndërsa ankesa e ankuesit është e pabazuar në tërësi dhe si e tillë është refuzuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me datë 20.08.2021, ka publikuar njoftimin lidhur përzgjedhjen përfundimtar të kandidatëve për pozitën e punës *“Zyrtar Ligjor 1”*, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri, sipas të cilit njoftim është poentuar si kandidatja e parë me gjithsej 437.75 pikë, si kandidatja e dytë me gjithsej 404.5 pikë, kandidati i tretë me gjithsej 394.25 pikë dhe si kandidatja e katër me gjithsej 392.5 pikë, edhe në këtë rast ankuesi ka qenë aplikues dhe nuk ka arrit numrin e pikëve për tu përzgjedhur.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me datë 20.08.2021, ka publikuar njoftimin lidhur përzgjedhjen përfundimtar të kandidatëve për pozitën e punës *“Zyrtar Ligjor 1”*, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, sipas të cilit njoftim është poentuar si kandidatja e parë me gjithsej 439.25 pikë, si kandidatja e dytë me gjithsej 429.00 pikë, kandidati i tretë me gjithsej 401.75 pikë, kandidati i katërt me 401.00 pikë dhe si kandidatja e pestë me gjithsej 374.00 pikë, edhe në këtë rast ankuesi ka qenë aplikues dhe nuk ka arrit numrin e pikëve për tu përzgjedhur.

Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare për pozitën zyrtar ligjor në Gjykatën Themelore Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës e ka publikuar me datën 20.08.2021, sipas të cilit njoftim është përzgjedhur znj. me 392.5 pikë e cila i ka plotësuar kriteret e konkursit. Andaj kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë shqyrtimit të provave të ankuesit dhe organit të punësimit ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën Zyrtar Ligjor në Gjykatën Themelore në Prishtinë-9 pozita". Gjykata Themelore në Mitrovicë 5 pozita, Gjykata Themelore në Mitrovicë dega në Vushtri 4 pozita, Gjykata Themelore në Mitrovicë –dega në Skenderaj 1 pozitë është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër KA.nr.49/2021 të datës 23.09.2021, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me A.nr.896/2021, 14.12.2021

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

